

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, bashkëpunëtorin profesional Feriz Berisha, në çështjen penale, kundër të pandehures A.A., për shkak të veprës penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4495/17, të dt.10.01.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës gjyqësore, me dt.10.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4495/17, të dt.10.01.2018, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

E pandehura: A.A., nga i ati M. dhe e ëma Xh., e gjinisë G., e lindur ... në P. rr. "B.R.", nr., më nr. ID...., e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetasee Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

S e p s e:

Me dt. 09.07.2017, rreth orës 21:35min, në kafiterinë "B.", në P., gjatë një kontrole nga ana e policisë tëpandehurës i është gjetur një sasi me substanca narkotike e llojit kanabis (mariuanë), në peshë prej 039 gram, të cilën e ka poseduar pa autorizim.

- **me këtë ka kryer veprën penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së**

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **300 (treqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **me 3 (tri) këste mujore.**

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

Obligohete akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor te paguajë shumën prej 20 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.4495/17, të dt.10.01.2018, e ka akuzuar A.A., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se e pandehura vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Raporti i policisë i datës 09.07.2017,vertetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve me nr. 2017-AD-1951 të datës 09.07.2017,raporti ekspertizës AKF/2017-2975/2017-2660,i datës 15.12.2017, deklarata e dëshmitares, pjesërisht nga vet deklarata e tëpandehurës, si dhe foto dokumentacioni me shkresat e tjera, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se e pandehura ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarës ekzistojnë elementet e veprës penale-Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 450 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 179/18, i dt.10.04.2018

Bashkëpunëtori profesional
Feriz Berisha

Gjyqtarja,
Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimin të tij, në këtë gjykatë.